



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONIERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 8.3.2023

Nr: 104

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE “PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË PUNËTORËVE TË SHQIPËRISË”, PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot më datë, 8.3.2023 në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me nr. 495 Prot., datë 30.1.2023, me:

Kërkues: Partia politike “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë”, me kryetar z. Kadri Isufaj

Objekti: Regjistrimi i partisë politike “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023

Baza ligjore: Neni 64 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të shqyrtimit administrativ

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Partia “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë”, nëpërmjet kryetarit të saj z. Kadri Isufaj, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore që do të zhvillohen më datë 14 maj 2023, administruar.

Data: 8.3.2023 Nr: 104
Ora: 11:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 16.1.2023, nëpërmjet të cilit vërtetohet se p
- b) artia “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë”, me initiale “PMDPSH”, me Kryetar z. Kadri Isufaj rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre;
- c) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- d) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike, (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është Partia “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë” me shkronja nistore “PMDPSH”, me adresë Rruga “George W Bush” Hyrja nr. 3, kati 2-të, Zyra nr. 110, përballë godinës së Parlamentit, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është z. Kadri Isufaj, me adresë, Rruga “George W Bush” Hyrja nr. 3, kati 2-të, Zyra nr. 110, përballë godinës së Parlamentit”, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është z. Ymer Kaceli me adresë Rruga “Punëtorët e Rilindjes”, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është z. Kadri Isufaj, me adresë, Rruga “George W Bush” Hyrja nr. 3, kati 2-të, Zyra nr.110, përballë godinës së Parlamentit, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga partia “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1 të nenit 64, të nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues kërkesës, i paraqitur nga partia “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë”, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, nenin 64, pika 2 dhe nenin 92 /2, pika 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të udhëzimit nr.1, datë 18.1.2023, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”

VENDOSA:

1. Regjistrimin e partisë politike “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë”, me kryetar z. Kadri Isufaj, me shkronjat nistore “PMDPSH”, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI